

VENDIM
Nr. 965, datë 25.10.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË PRONËS NR. 37, ME EMËRTIMIN “MINISTRIA E MBROJTJES”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “DËSHMORËT E KOMBIT”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

(Ndryshuar me VKM nr. 501¹, datë 30.7.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës nr. 37, me emërtimin “Ministria e Mbrojtjes”, me vendndodhje në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 8489.2 (tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë pikë dy) m² dhe sipërfaqe nën objekt 3456.8 (tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) m², sipas planvendosjes dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për mjedise pune për përmbushjen e veprimtarisë e të detyrave të tyre funksionale, sipas ndarjes së mëposhtme: 7628

a) Ministrisë së Financave t’i kalojë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja e përgjithshme 4951 (katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) m², nga e cila sipërfaqe nën objekt 2199 (dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², sipas planimetrisë dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij;

b) Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t’i kalojë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja e përgjithshme 3538.2 (tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë dy) m², nga e cila sipërfaqe nën objekt 1257.8 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë pikë tetë) m², si dhe bodrumi i godinës nga rruga “Myslym Shyri”, sipas planimetrisë dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

b/1) Nga sipërfaqja e përgjithshme, kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, objekti me sipërfaqe 673 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) m², pjesë e pronës me nr. 37, me vendndodhje në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.

2. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të zhvendosen në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe në një pjesë të mjedisëve të Forcës Tokësore, në Babru, Tiranë.

3. Prona nr. 37, me emërtimin “Ministria e Mbrojtjes”, me vendndodhje në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

4. Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

¹ VKM nr. 501, datë 30.7.2014 në pikën 2 shprehet;

“2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ndalohe të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

(Shtuar planvendosja me VKM nr. 501, datë 30.7.2014)

Sipërfaqja e objektit që kërkohet për kalim kapital nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)



